Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës
Nr. 01-020/04-0065573-2/26 **dt.** 09.11.2026
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenet 8, 16, 17 dhe 18 të Rregullores MF Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, dhe Propozim-Vendimin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 01-020/04-0065573/26, dt. 05.11.2026, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

(Për Formimin e Komisionit për Vlerësimin e Projekteve në Fushën e Kulturës për Projekte/Programe të OJQ-ve për Thirrjen e Dytë Publike për Vitin 2026)

1. **Formohet** Komisioni për Vlerësimin e projekteve të cilët kanë aplikuar në Thirrjen Publike për financim të OJQ-ve në fushën e kulturës për projekte/programe të OJQ-ve për thirrjen e dytë publike për vitin 2026, në këtë përbërje:

   1.1 Nazmi Racaj – Kryesues (DKRS);
   1.2 Merita Kelmendi – Anëtare (Drejtore e Bibliotekës);
   1.3 Fjolla Carani – Anëtare (DBF);
   1.4 Muharrem Beka – Anëtar (Ekspert);
   1.5 Hamide Hyseni – Anëtare (Përfaqësues nga Shoqëria Civile);
   1.6 Lule Veseli – Anëtare rezervë (DKRS).

2. Komisioni është përgjegjës që të bëjë vlerësimin e të gjitha projekteve që janë dorëzuar për përfitimin e subvencioneve në fushën e kulturës në përputhje me Rregulloren MF Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve duke bërë vlerësimin e tyre si nga aspekti procedural, po ashtu dhe ai përmbajtjesor në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh.

3. Gjatë fazës së vlerësimit komisioni obligohet që të mbajë Procesverbal nga momenti i hapjes së procesit e deri në marrjen e Vendimit për secilin projekt, duke përfshirë dhe pikët me rastin e vlerësimit. Pas përfundimit të vlerësimit komisioni duhet të përgatitë një Raport të përgjithshëm me projektet e miratuara, po ashtu dhe ato të refuzuara së bashku me listën e përfituesve dhe të njëjtin të publikojë në ueb faqen e komunës brenda 7 (shtatë) ditësh nga data e marrjes së Vendimeve.

4. Komisioni punues bazë për punën e tij do të ketë: Rregulloren MF Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Ligjin Nr. 05/L-031 për

Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.

5. Komisioni i formuar sipas pikës një (1) të këtij Vendimi ka mandat deri në përfundimin e fazës së vlerësimit.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës

Faton PECI

Shtojcë:
1x1 Propozim - Vendimi i DKRS-së, Nr. 01-020/04-0065573/26, dt. 05.11.2026,
1x1 Thirrja e Dytë Publike të Vitit 2026, data e hapjes 26.10.2026.

Ti dërgohet:
1x1 Kryetarit të Komunës
1x1 Zyrës Ligjore
1x1 Zyrës për Informim
1x1 Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
1x1 Anëtarëve të Komisionit
1x1 Arkivit